



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE

RELACION

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.60 DATE 18.12.2019 PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË BASHKINË BERAT”

Të nderuar keshilltar !

Pranë tregut industrial Berat ushtrojnë aktivitetin e tyre tregtar 198 qytetarë, të drejtat dhe detyrimet e të cilëve rregullohen nga kontratat individuale midis tyre dhe Bashkisë Berat. Në udhëzim nr.1 datë 12.01.2007 “Për përcaktimin e veprimitarive që trajtohen si veprimtari, tregtare apo shërbimi, ambulanti si dhe procedurat e regjistrimit të tyre në organin tatimor”, përcaktohet e drejta dhe detyrimi për tu regjistruar e të vetëpunësuarve në aktivitet tregtar apo shërbim ambulant, që kryejnë tregti në tregjet e miratuara nga organet e qeverisjes vendore. Në këto kushte, me regjistrimin e tyre kjo kategori bëhet subjekti i Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.60 datë 18.12.2019 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Berat” dhe kanë detyrimin ligjor për të paguar tarifën e shërbimeve që ofron Bashkia Berat. Në funksion të nxihtës së biznesit, lehtësimi të kësaj kategorie e cila ka për shkak të vendodhjes së tyre larg qendrës dhe zonave të zhvillimit arrijnë fitime mujore më të vogla sesa pjesa tjetër e qytetit, si dhe për të mundësuar ushtrimin e aktivitetit tregtar jo në mënyrë informale, propozojmë mbeshetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 35, përfundimisht e tyre nga tarifën e ndriçimit, gjelberimit, pastrimit dhe arsimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

PROJEKTVENDIM

**PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT
BASHKIAK NR.60, DATË 18.12.2019, "PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE
TARIFAVE VENDORE NË BASHKINË BERAT"**

Kryetari i Bashkisë në mbështetje të gërmës "f" të nenit 54, gërmës "c" të nenit 64 të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligjit nr.68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjit nr.9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar,

PROPOZON:

1.Në VKB nr.60, datë 18.12.2019, "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Berat", pika 6, pas pjesës"Afater", shtohet paragrafi me përmbajtje si më poshtë:

Tregtarët ambulantë që tregtojnë në tregun industrial, lagjja "30 Yjetori", Berat, përjashtohen nga pagesa e tarifës së pasrimiti e mirëmbajtjes së hapësirave publike, tarifës së ndriçimit, tarifës së gjelbërimit dhe tarifës infrastrukturës arsimore, të përcaktuara në këtë vendim".

2.Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohen drejtoritë, njësitë vartëse dhe njësitë administrative të Bashkisë Berat.

KRYETARI I BASHKISË

Ervin Demo